

V E N D I M
Nr. 293, datë 12.5.2001

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E MJEKËSISË
VETERINARE, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË SHTETIT TË IZRAELIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 17 dhe 23, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1995, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e mjekësisë veterinare, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Izraelit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

MARREVESHJE

**E BASHKEPUNIMIT NE FUSHEN E
MJEKSISE VETERINARE**

NDERMJET

QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE

DHE

QEVERISE SE SHTETIT TE IZRAELIT

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shtetit të Izraelit (me poshte të quajtura "Pale Kontraktuese");

TE NISURA nga dëshira për zhvillimin dhe thellimin e bashkëpunimit midis dy vendeve në fushën e Mjekësisë Veterinare për përfitimin reciprok të popujve të tyre; dhe

ME DESHIREN për zhvillimin e metejshëm të marrëdhënieve, miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet dy Shteteve;

RANE DAKORT sa me poshte:

Neni 1

Palet Kontraktuese do të bashkëpunojnë në mbrojtjen e territoreve të vendeve të tyre kundër hyrjes së semundjeve epizootike si pasoje e importit, eksportit dhe tranzitit të kafshëve të gjalla, lendeve të para dhe produkteve me origjinë shtazore dhe lendeve të cilët mund të jenë vektore patogjene.

Importimi i kafshëve të gjalla, lendeve të para, produkteve me origjinë nga kafshët dhe lendeve të cilët mund të jenë vektore patogjene dhe tranzitimi i kafshëve të cilët mund të jenë mbartës të ndonjë semundje infektive ose parazitare të kafshëve dhe zoonozike, duhet të shoqëruar vetëm me lejen veterinare sanitare paraprakisht të leshuar nga autoritetet veterinare përgjegjëse të vendeve importuese, respektivisht të vendeve përmes të cilave tranziti është kryer.

Neni 2

Palet Kontraktuese do të përfshijë, edhe, protokollet e përbashkëta me qëllim të vendosjes së kërkesave veterinare të importimit, eksportimit dhe tranzitit për kafshët e gjalla, lëndet e para, produkteve shtazore dhe materialeve, të cilat mund të jenë vektore patogjene të cilët nevojitet t'i nënshtrohen kontrollit të autoriteteve veterinare të kufirit.

Neni 3

Palet Kontraktuese rane dakort që Certifikatat Veterinare të përdorura për eksportin e kafshëve të gjalla dhe të prodhimeve shtazore duhet të jenë nënshkruar nga veterinerët zyrtarë të autorizuar vecanerisht. Të dy vendet do të kenë të drejtën të përgatisin kërkesat e tyre të shëndetit për import.

Secila ngarkesë me kafshë të gjalla, lende të para, produkte shtazore dhe lëndet të cilat mund të jenë vektore patogjene duhet të shoqërohet nga Certifikata Veterinare. Certifikata Veterinare do të jete e vlefshme për 10 dite nga data e leshimit. Certifikata duhet të jete në gjuhën e vendit eksportues dhe përfshirë edhe përkthimin në anglisht.

Neni 4

• Palet Kontraktuese do të emerojnë pika të vecanta të kontrollit veterinar kufitar për importet, eksportet dhe tranzitimet midis tyre të kafshëve të gjalla, lendeve të para, produkteve shtazore dhe materialeve që mund të jenë vektore patogjenik. Me miratimin me shkrim reciprok të Paleve Kontraktuese, në qoftëse është e nevojshme këto pika mund të ndryshohen, hiqen dhe të tjera të reja mund të krijohen.

Neni 5

Kur kërkohet, Palet Kontraktuese do të informojnë njeri tjetrin menjëherë rreth ndonjë sëmundje emergjente në territoret e tyre.

Neni 6

1. Palet kontraktuese angazhohen të:

- a) Informojnë njera tjetren brenda 24 orëve rreth ndonjë sëmundje që përfshihet në listën "A" të OIE- Paris të shfaqur në vendet e tyre, rreth specit, numrin e kafshëve të sëmurë, vendin ku sëmundja ka qenë raportuar, diagnozën, dhe në rastet e FMD - rreth tipit të virusit të vecuar dhe rreth masave të cilat kanë qenë marrë për kontrollin e sëmundjeve respektive.
 - b) Të shkëmbejnë çdo muaj buletinet zyrtare veterinarë që tregojnë statistikën e sëmundjeve infektive dhe ngjitesë të kafshëve, sipas listave "A" dhe "B" të Zyres Nerkombetare të Epizootive.
2. Në qoftëse në territoret e njera nga Palet Kontraktuese ka ndonjë raportim të sëmundjeve të sipërpermendura në nenin 6 1-a), Pala e prekur do të sigurojë Palen tjetër për llojin e patogjenit, nëqoftëse është e realizueshme.
3. Në rastet e sëmundjeve emergjente të Listës "A" të OIE, Pala që ndalon importin dhe tranzitimin do të informojë palen tjetër rreth ndalimit brenda 24 orëve. Ky vendim do të zbatohet 3 ditë pas raportimit të ndalimit. Megjithatë, në rastet e jashtëzakonshme, me miratimin e Paleve Kontraktuese, tranzitimi mund të lejohet.

Neni 7

Palet Kontraktuese do të nxisin bashkëpunimin në fushat e kërkimeve Veterinarë të zbatuara dhe aktiviteteve Veterinarë nga:

- a) Shkëmbimin e eksperiencës dhe njohurive në trainimet profesionale;
- b) Bashkëpunimin midis instituteve të specializuara dhe Sherbimeve Veterinarë Qendrore;
- c) Shkëmbimin e informacionit dhe vizitave të specialistëve dhe punonjësve shkencorë;
- d) Shkëmbimin e gazetave shkencore dhe publikimeve të tjera në mjekësinë Veterinarë të aplikuar;
- e) Shkëmbimin e informacionit në organizimin e aktiviteteve Veterinarë dhe parashikimet ligjore dhe instruksionet në këtë fushë.

Neni 8

Autoritetet zbatuese për propozimet e kësaj Marrëveshjeje do të jenë, në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Drejtoria e Veterinarisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe në emër të Shtetit të Izraelit, Sherbimi Veterinar dhe i Shëndetit të Kafshëve në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 9

Kostot financiare që dalin për përmbushjen e Marrëveshjes do të mbulohen si më poshtë:

- a) Shkembimi i gazetave Veterinare dhe publikimeve do te financohet nga Pala Kontraktuese derguese;
- b) Ne rastet kur njera nga Palet Kontraktuese bejne kerkese per specialiste ose punonjes shkencore, te gjitha shpenzimet do te mbulohen nga kerkuesi; ne rastet e seminareve ose mbledhjeve shkencore, shpenzimet e udhetimit do te mbulohen nga Pala Kontraktuese derguese, ndersa shpenzimet e qendrimit do te mbulohet nga vendi prites.

Shpenzimet e udhetimit nderkombetar per permbushjen e kushteve te Nenit 7, pika c) do te mbulohen nga Pala Kontraktuese derguese, ndersa shpenzimet e qendrimit do te mbulohen nga vendi prites.

Neni 10

Ne rastet e ndonje mosmarreshjeje midis Paleve Kontraktuese ne lidhje me zbatimin e kesaj Marreshjeje do te shqyrtohet nga nje komision i perbashket.

Ky komision do te perbehet nga tre perfaqesues nga secila Pale Kontraktuese.

Komisioni do te mblidhet brenda 30 diteve pas thirrjes nga nje nga Palet Kontraktuese, ne territorin e tij, dhe do te punoje ne mbledhje kryesuar ne menyre te alternuar nga nje anetar i seciles Pale Kontraktuese.

Problemet e lena te pazgjidhura nga komisioni do te zgjidhen ne rruge diplomatike.

Neni 11

Kjo Marreshje nuk do te ndikojte tani ose ne te ardhmen ne te drejtat dhe/ose detyrimet e Paleve ne pajtim me Marreshjet dhe Traktatet e tjera Nderkombetare, perfunduar me pare nga secila prej tyre.

Neni 12


Kjo Marreshje eshte subjekt i modifikimeve dhe shtesave me pelqimin e te dyja Paleve Kontraktuese. Cdo modifikim ose shtese ne Marreshje do te ndjekte procedure te njejte si hyrja e saj ne fuqi.

Neni 13

Kjo Marreshje do te hyje ne fuqi ne ditën e dyte te njoftimit te Notave me ane te te cilave Palet Kontraktuese njoftojne njera tjetren ne rruge diplomatike per plotesimin e procedurave tjere ne perputhje me ligjet kombetare te secilit vend ne lidhje me kete ceshtje.

Kjo Marreshje do te jete e vlefshme per nje periudhe tre (3) vjecare. Paskesaj, vlefshmeria e saj do te zgjatet automatikisht per nje periudhe shtese (2) dy vjecare, derisa njera nga Palet Kontraktuese e denoncon ate me shkrim, te pakten gjashte (6) muaj perpara perfundimit te periudhes perkatese.

BERE ne Jerusalem me 9 janar 2001, e cila korrespondon me 13 Tevet 5761, ne tre kopje origjinale ne shqip, hebraisht dhe anglisht, te tre tekstet njelloj te vlefshme. Ne raste shmangie te interpretimit teksti anglisht mbizoteron.



PER QEVERINE E
REPUBLIKES SE SHQIPERISE



PER QEVERINE E
SHTETIT TE IZRAELIT